

Data 03.03.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pjese kembimi per automjete fugone dhe makina per transport mallrash 34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.661.252 (katwr milion e gjashtwqind e gjashtwdhjetw e njw mijwe dyqind e peswdhjetw e dy) leke pa t.v.sh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*
- c. Formulari i ofertes ,sipas shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare.2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020-2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41,

pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

- 2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë, një ambient për ushtrimin e aktivitetit të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) brenda territorit administrativ të Bashkisë së Gjirokastrës. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësise ose nese e ka me qira, kontratën noteriale të qirase të objektit në vendodhjen e sipërpermendur.

Argumentim;

LPP neni 36 specifiimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 41 pika

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkohet të jetë brenda territorit administrativ të Bashkisë Gjirokastër kjo për arsye sepse mjetet dhe sidomos mjetet teknologjike nuk mund të përshkruajnë një rrugë tepër të gjatë për të bërë riparimin e mjeteve kjo pasi do të kishte një kosto tepër të lartë dhe gjithashtu një harxhim kohe më të madhe

- 2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë me dokument ligjor se disponon 2(dy) ura ngritëse dhe te pakten nje diagnostikues difektesh elektrike per automjetet, për vërtetimin e të cilave mund të shërbejnë fatura tatimore të shitjes dhe pasqyrimi si asete në bilancin e dorëzuar pranë administratës tatimore.

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 41 pika

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Numri i mjeteve për tu riparuar është i lartë dhe për të pasur një riparim në kohë dhe mundësi nuk është i mjaftueshëm vetëm një urë dhe kjo do të pengonte rrëgullimin në kohën e duhur.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 3(tre) gropa për mjete me tonazh të lartë, për vërtetimin e të cilave duhet të paraqesë foto të ambienteve përkatëse. Gjithashtu, autoriteti kontraktor rezervon të drejtën, që gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave, të kryejë verifikimin në vend për këtë kriter.

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 41 pika

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Bashkia Gjirokastë disponon disa mjetë teknologjike të cilat kanë një tonazh tepër të lartë për tu cuar nga urat ngritëse për riaprimine tyre.

- 2.3.5** Operatori ekonomik te jete i pajisur me licëse autoriparimi te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio me Kod VII.3.B.1., për veprimtaritë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit, për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocërisë, për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik.

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 41 pika 1a) a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

Në bazë të Udhëzimit nr 1546 datë 29.03.2016 neni 2 citoheet se:

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

- 2.3.6** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në të cilin duhet të përmbahen të dhënat në lidhje me fillimin e veprimtarisë, llojin e veprimtarisë që do të ushtrohet, si dhe të dhënat e administruara në regjistrin e hapur pranë drejtorisë përkatëse, për këtë lloj aktiviteti.

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 41 pika 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

- 2.3.7** Operatori ekonomik te jete pajisur me Leje Mjedisore per aktivitetin ekonomik objekt I tenderit, le lëshuar nga QKL.

- 2.3.8** _Operatori ekonomik pjesmarrës për realizimin e kësaj kontrate , duhet të ketë të punësuar si përgjegjës teknik për periudhën kohore Dhjetor 2022 deri në Shkurt të vitit 2023 të vërtetuar këtë me anë të listëpagesave , jo më pak, se:

1(një) inxhinier mekanik,

Për inxhinierin mekanik duhet të disponojë:

- Diplomë
- Kontartë pune të vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës

- Dëshmia e aftësisit profesional” e vlefshme, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41 pika 1b) b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë të përfshirë në listëpagesat e muajit Dhjetor 2022 deri në Shkurt të vitit 2023:

- 1(nje) teknik motorist,
- 2(dy) mekanik-xhenerik,
- 1(nje) elektro-auto per mjete transporti.

Për secilin specialist të sipërcituar duhet të paraqitet:

- Kontratë punë e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës
- Dëshmi kualifikimi

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentim;

LPP neni 36 specifikimet teknike

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41 pika 1c) c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim.

Argumentim; Kjo kërkesë është konform Njoftimit të Përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1155 prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 1001/1 Prot., datë 01.02.2019 drejtuar Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomik për ndalim të dhënies së kontratave publike operatorëve ekonomik për një listë të veprave penale por edhe kur një dënim e kanë individët, administratorët apo përfaqësuesit e subjektit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Alfons Alikaj

Alma Llaci

Lorjana Shehu